

Joli Mitrojorgji është arkitekte restauratore, e lindur në Lezhë, më datë 21.06.1985 dhe prej muajit Janar 2025 mban pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

Ajo ka një diplomë Master Shkencor në Arkitekturë nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës përfunduar në 2010 dhe një Master Profesional në Dizajn Arkitekturor nga Universiteti i Navarrës, Pamplona, Spanjë, përfunduar në 2012.

Në vitin 2017 ajo mori pjesë dhe përfundoi me sukses programin DIPLOMAzia2, një kurs trajnimi 6-mujor për profesionistët e rinj mbi Trashëgiminë Kulturore, të mbajtur nga Centro Nazionale delle Ricerche në Itali.

Gjithashtu, ka qenë pjesë e një sërë trajnimesh të zhvilluara nga UNESCO, ICCROM, ICOMOS, INTERPRETIVE EUROPE ndër vite.

Që nga viti 2014 ajo punon pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, duke mbajtur disa pozicione ndër vite dhe duke fituar përvojë profesionale në hulumtimin, mbrojtjen, restaurimin dhe konservimin e arkitekturës popullore, arkitekturës antike-mesjetare, njohuri në zhvillimin e trajnimeve të profesionistëve të rinj dhe komunikimit me organizatat ndërkombëtare bashkëpunëtoresh të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

Përveç eksperiencës rreth aspekteve teknike që lidhen me pasuritë kulturore, ajo njeh shumë mirë legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore duke qenë pjesë e grupeve të hartimit të një numri të madh aktesh për deklarimin e interesit kulturor, shpalljen e qendrave historike apo edhe rishikimin e akteve nënligjore.

Si pjesë e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, ajo ka mbajtur një sërë pozicionesh, si specialist pranë sektorit të Qendrave Historike dhe Arkitekturës së Traditës dhe Peizazhit - SQHATP, Përgjegjëse sektori e SQHATP, përgjegjëse e sektorit të Veprave të Artit, përgjegjëse e sektorit të Arkitekturës Antiko-Mesjetare, përgjegjëse e sektorit të Qendrës Rajonale për Konservimin dhe Restaurimin e Evropës Juglindore dhe prej gusht 2024 Drejtoreshë e Drejtorisë së Monumenteve të Kulturës pranë IKTK.

Krahas aspektit profesional, ajo është e angazhuar në fushën akademike si pedagoge me kohë të pjesshme në Universitetin Politeknik të Tiranës në degët e arkitekturës dhe të masterit profesional të restaurimit të monumenteve dhe Universitetit EPOKA.

Gjithashtu, është autore dhe bashkëautore e artikujve të ndryshëm kërkimor-shkencor dhe shkrimeve mbi trashëgiminë kulturore, me botime në revistën shkencore “Monumentet” dhe botime si “Forma, Arkitektura dhe Përmbajtja – një udhëtim në arkitekturën popullore shqiptare” e “Për cilin qytet e ke fjalën?”.

Ajo po zgjeron fushën e saj të ekspertizës në lidhje me trashëgiminë kulturore dhe së fundmi është licencuar si Planifikuese e Çertifikuar Interpretuese dhe përfaqëson zyrtarisht Shqipërinë si Koordinatore Vendore për Evropën Interpretive.